



# **RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS**

## Përmbledhje

PËRGJEGJËSITË E AAC-së.....	3
OBJEKTIVAT E AAC-së PËR VITIN 2023.....	4
1. PLOTËSIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR.....	4
1.1 Transpozimin e acquis-së së BE-së në fushën e aviacionit.....	4
1.2 Përvetësimin e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të përditësuara nga ICAO.....	6
1.3 Hartimin e akteve tjera nënligjore të aviacionit për zbatimin e Ligjit për Aviacionin Civil, bazuar në specifikat e vendit.....	6
1.4 Nxjerrjen e Urdhëresave dhe Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Rregulloreve.....	6
1.5 Nxjerrjen e Vendimeve Ekzekutive për zbatimin e specifikave të certifikimit dhe e mjeteve tjera të pranueshme të pajtueshmërisë.....	6
2. CERTIFIKIMI I OPERATORËVE, LICENCIMI I PERSONELIT DHE MBIKËQYRJA E VAZHDUESHME.....	7
2.1 Certifikimi i operatorëve të aviacionit.....	7
2.2 Licencimi i personelit të aviacionit (licencimi i kontrollorëve dhe paraglajdistëve, lëshimi i certifikatave mjekësore, etj.).....	7
2.3 Lëshimi i lejeve për fluturimet VFR dhe ato diplomatike, për mallrat e rrezikshme, për operimet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron).....	8
2.4 Aprovimi i fluturimeve për mjetet e huaja ajrore civile.....	9
2.5 Regjistrimi i operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP/dronëve) dhe nxjerra e vendimeve për operimet e paautorizuara me këto sisteme.....	9
2.6 Mbikëqyrja e vazhdueshme e operatorëve dhe mbikëqyrja e brendshme.....	10
2.7 Mbikëqyrja ekonomike e operatorëve të aviacionit (ASHNA-s, ANP “Adem Jashari” LKIA dhe shërbyesve në tokë).....	20
2.8 Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion (trajtimi/ hetimi i ndodhive, futja e tyre në formatin/bazën e të dhënave në ECCAIRS).....	21
3. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL DHE NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE.....	23
3.1 Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.....	23
3.2 Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale.....	24
3.3 Aranzhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritet shtetërore për mbrojtjen e mjedisit.....	25
3.4 Implementimi i Projektit të Bashkëpunimit Teknik të EASA-s, EASA IPA-6.....	26
3.5 Normalizimi i hapësirës ajrore.....	26
4. BUXHETI I AAC-së PËR VITIN 2023.....	29
5. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E PLANIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN VIJUES DHE ADRESIMIN E PROBLEMEVE TË HASURA GJATË ZBATIMIT.....	30

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS 2023

## PËRGJEGJËSITË E AAC-së

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) është agjenci rregullatore përgjegjëse për rregullimin e sigurisë në aviacionin civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura.

AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik dhe për performancën dhe veprimtarinë e saj i përgjigjet Qeverisë së Kosovës, nëpërmjet Ministrit përgjegjës për transport.

AAC është përgjegjëse për:

- a) Zbatimin e legjislacionit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga Ministria ose Qeveria në fushën e Aviacionit Civil;
- b) Ofrimin e këshillave dhe propozimeve për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e Aviacionit Civil;
- c) Nxjerrjen e rregullave të zbatimit dhe urdhërave për siguri të navigimit ajror, në përputhje me Ligjin bazik dhe Marrëveshjen HPEA, me qëllim të zbatimit të politikave të Aviacionit Civil të Ministrisë dhe legjislacionit përkatës nga fusha e Aviacionit Civil;
- d) Lëshimin e Licencave, Certifikatave dhe Lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së;
- e) Rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- f) Rregullimin ekonomik të tregut të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror;
- g) Ofrimin e këshillave për Ministrinë në lidhje me përgatitjen e propozim-politikave mbi shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, duke pasur parasysh sigurinë kombëtare, faktorët ekonomik dhe mjedisor, nevojën për standarde të larta të sigurisë;
- h) Mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhërave të aviacionit civil, përveç, kur me Ligjin bazik ose me një Akt tjetër juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë Ministrisë ose një autoriteti tjetër publik;
- i) Shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC;
- j) Në përputhje me dispozitat dhe qëllimin e Ligjit bazik, marrjen e masave, kryerjen e hetimeve, inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhërave, rregullave, Rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC me arsye i konsideron të nevojshme për: (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit bazik ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat i janë dhënë AAC me Ligjin bazik;
- k) Ushtrimin e funksioneve të tjera të cilat kanë të bëjnë me Aviacionin Civil në Kosovë, që janë dhënë sipas Ligjit bazik ose legjislacionit tjetër në fuqi.

Në përputhje me planin e performancës për vitin 2023 të AAC-së të dorëzuar në Qeveri të Republikës së Kosovës më dt. 30.11.2022, më poshtë është përgatitur Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2023.

## OBJEKTIVAT E AAC-së PËR VITIN 2023

### 1. PLOTËSIMI I LEGJISLACIONIT SEKONNDAR

Plotësimi i legjislacionit sekondar përmes zbatimit të kërkesave të përbashkëta të aviacionit që rrjedhin nga Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), përfshirë:

- Transpozimin e acquis-së së BE-së në fushën e aviacionit;
- Përvetësimin e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të përditësuara nga ICAO;
- Hartimin e akteve tjera nënligjore të aviacionit për zbatimin e Ligjit për Aviacionin Civil, bazuar në specifikat e vendit;
- Nxjerrjen e Urdhërave dhe Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Rregulloreve; dhe
- Nxjerrjen e Vendimeve Ekzekutive për zbatimin e specifikave të certifikimit dhe e mjeteve tjera të pranueshme të pajtueshmërisë.

#### 1.1 Transpozimin e acquis-së së BE-së në fushën e aviacionit

AAC-ja aplikon procedurë transparente gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2012 të AAC-së për procedurat e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore të AAC-së i nënshtrohen procesit të konsultimit publik të palëve të interesit. Ky konsultim ndjek procedurat dhe afatet kohore të dhëna, gjatë të cilit, çdo palë e interesit, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtën e dhënies së komenteve, sugjerimeve apo të kërimit të informacioneve shtesë nga strukturat e AAC-së, të cilat e nxjerrin një projekt-akt në konsultim publik. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, strukturat e AAC-së brenda 2 javëve janë të obliguara që të përgatisin një raport, në të cilin do t'i ofrojnë përgjigjet e tyre në komentet e pranuar, ku duhet të shpjegohen arsyet për pranimin apo mospranimin e sugjerimeve për ndryshim të dispozitave të projekt-aktit nënligjor që është objekt i konsultimit publik. Publikimi i akteve nënligjore të AAC-së bëhet në platformën elektronike të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

Gjatë vitit 2023, ashtu siç ishte e paraparë në planin e performancës, AAC ka nxjerrë nëntë (9) Rregullore, të cilat kanë transpozuar në rendin e brendshëm juridik njëmbëdhjetë (11) Rregullore të acquis-së së BE-së në fushën e aviacionit.

Në vazhdim është lista e këtyre aktet nënligjore, të nxjerra gjatë vitit 2023:

- Rregullore (AAC) nr. 01/2023 për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 17/2017 në lidhje me dispozitat për operime në çfarëdo kushte të motit dhe në lidhje me definicionin për SNOËTAM. Qëllimi i kësaj Rregullore është transpozimi i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/208 të datës 14 dhjetor 2021 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 139/2014 në lidhje me dispozitat për operime në çfarëdo kushte të motit dhe transpozimin e Rregullores së Deleguar 2022/2074 të datës 20 korrik 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 139/2014, në lidhje me definicionin për SNOËTAM. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm më dt. 29 mars 2022.
- Rregullore (AAC) nr. 02-2023 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2019 në lidhje me zbatueshmërinë e kërkesave për gjetjen e një mjeti ajror në rrezik. Qëllimi i kësaj rregulloreje është zbatimi i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2022/2203 të datës 11 nëntor 2022 që e ndryshon Rregulloren nr. 965/2012 (BE) në lidhje me zbatueshmërinë e kërkesave për gjetjen e një mjeti ajror në rrezik, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm më dt. 07 prill 2023.
- Rregullore (AAC) nr. 03-2023 që ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 06/2015 në lidhje me zbatimin e kërkesave më proporcionale për mjetet ajrore që përdoren për aviacion sportiv dhe rekreativ. Qëllimi i

kësaj rregulloreje është zbatimi i Rregullores së deleguar të Komisionit (BE) 2022/1358 e datës 2 qershor 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 748/2012 sa i përket zbatimit të kërkesave më proporcionale për mjetet ajrore që përdoren për aviacion sportiv dhe rekreativ, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm më dt. 15 maj 2023.

- Rregullore (AAC) nr. 04-2023 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 06/2015 në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe sistemet e raportimit të ndodhive që do të vendosen nga organizatat projektuese dhe prodhuese, si dhe procedurat e aplikuara nga Agjencia, për korrigjimin e kësaj Rregulloreje dhe të derogimit prej disa kërkesave. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) 2022/201 të datës 10 dhjetor 2021 e cila amandamenton Rregulloren (BE) 748/2012 në lidhje me sistemet e menaxhimit dhe sistemet e raportimit të ndodhive që do të vendosen nga organizatat e projektimit dhe prodhimit, si dhe procedurat e aplikuara nga Agjencia, dhe korrigjimin e kësaj rregulloreje, si dhe Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2022/1253 të datës 19 korrik 2022 e cila korrigjon Rregulloren (BE) 748/2012 sa i përket derogimit nga disa kërkesave të paraqitura nga rregullorja Deleaguese (BE) 2022/201, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm më dt. 29 mars 2022.

- Rregullore (AAC) nr. 05-2023 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 12/2015 në lidhje me listën e transportuesve ajrorë të cilëve u është ndaluar të operojnë ose i nënshtrohen kufizimeve operacionale brenda Republikës së Kosovës. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është traspozimi në rendin juridik të Republikës së Kosovës i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2022/2295 e datës 23 nëntor 2022 e cila ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 474/2006 në lidhje me listën e transportuesve ajrorë të cilëve u është ndaluar të operojnë ose i nënshtrohen kufizimeve operacionale. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm më dt. 30 qershor 2023.

- Rregullore (AAC) nr. 06-2023 që ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 15/2017 në lidhje me futjen e kërkesave të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2022/1254 e datës 19 korrik 2022 e cila ndryshon Rregulloren (BE) 2015/640 në lidhje me futjen e kërkesave të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Drejtori i përgjithshëm më dt. 30 qershor 2023.

- Rregullore (AAC) Nr. 08/2023 për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 08/2018 lidhur me zbatimin e kërkesave më proporcionale për mjetet ajrore që përdoren për aviacion sportiv dhe rekreativ. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) 2022/1360 e datës 28 Korrik 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 1321/2014 lidhur me zbatimin e kërkesave më proporcionale për mjetet ajrore që përdoren për aviacion sportiv dhe rekreativ, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Zv. Drejtori i përgjithshëm më dt. 02 tetor 2023.

- Rregullore (AAC) Nr. 09/2023 për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 06/2015 në lidhje me detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të autoriteteve kompetente në implementimin e rregullave në lidhje me organizatat e përfshira në projektimin dhe prodhimin e fluturakëve të përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Implementuese të Komisionit (BE) Nr. 2022/1361 e datës 28 Korrik 2022 që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 748/2012 në lidhje me detyrat e certifikimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të autoriteteve kompetente në implementimin e rregullave në lidhje me organizatat e përfshira në projektimin dhe prodhimin e fluturakëve të përdorur për aviacion sportiv dhe rekreativ, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Zv. Drejtori i përgjithshëm më dt. 02 tetor 2023.

- Rregullore (AAC) nr. 10/2023 për përcaktimin e masave për zbatimin e rregullores (AAC) nr. 09/2017 lidhur me skemë e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është zbatimi i Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2021/2082, të datës 26 nëntor 2021 për

përcaktimin e masave për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 376/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me skemën e përbashkët evropiane të klasifikimit të rrezikut, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Zv. Drejtori i përgjithshëm më dt. 02 tetor 2023.

## **1.2 Përvetësimin e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të përditësuara nga ICAO**

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur të planifikuar ndonjë veprim lidhur me përvetësimin e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të përditësuara nga ICAO. Për shkak që Republika e Kosovës nuk është anëtare në ICAO, autoritetet aeronautike të vendit tonë nuk kanë qasje në dokumentacionin relevantë dhe informata zyrtare lidhur me përditësimet e Standardeve dhe Praktikave të Rekomanduara të ICAO-së. Sidoqoftë gjatë këtij viti në takimet e mbajtura në mes të AAC-së të Kosovës dhe AAC-së së Maqedonisë së Veriut është dakorduar që në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit mes të dy autoriteteve të shkëmbehen këto informata përmes letrave shtetërore, të cilat autoriteti maqedonas i pranon nga ICAO.

## **1.3 Hartimin e akteve tjera nënligjore të aviacionit për zbatimin e Ligjit për Aviacionin Civil, bazuar në specifikat e vendit**

Në vijim është Rregullorja e AAC-së në fushën e sigurisë së navigim ajror e cila është nxjerr në përputhje me specifikat e legjisllacionit vendor të aviacionit civil:

- Rregullore (AAC) Nr. 07/2023 për ndryshimin e Rregullores nr. 01/2018 mbi kërkesat për ofruesit e shërbimeve në lidhje me trajnimin dhe vlerësimin e kompetencës për personelin e elektronikës të sigurisë të trafikut ajror (ATSEP). Qëllimi kësaj Rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores (AAC) nr. 01/2018 sa i përket nivelit të aftësisë gjuhësore të ATSEP. Kjo Rregullore është nënshkruar nga Zv. Drejtori i përgjithshëm më dt. 27 shtator 2023.

## **1.4 Nxjerrjen e Urdhëresave dhe Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Rregulloreve**

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndonjë nevojë për nxjerrje të Urdhëresave apo Udhëzimeve Administrative për zbatim të Rregulloreve të AAC-së.

## **1.5 Nxjerrjen e Vendimeve Ekzekutive për zbatimin e specifikave të certifikimit dhe e mjeteve tjera të pranueshme të pajtueshmërisë**

Në vijim janë listuar vendimet ekzekutive të lëshuara nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së gjatë vitit 2023:

- Vendimi 01/ZDP/VE/2023, dt. 30 janar 2023, për vazhdim të aprovimit për shërbime në tokë për pale të treta për subjektin afarist "Ex Fis" sh.p.k.;
- Vendimi 02/ZDP/VE/2023, dt. 24 mars 2023, për vazhdim të mandatit të Komisionit të caktuar me Vendimin 08/ZDP/VE/2022;
- Vendimi 03/ZDP/VE/2023, dt. 30 mars 2023, për vazhdim të aprovimit për shërbime në tokë për palë të treta për operatorin LKIA;

- Vendimi 04/ZDP/VE/2023, i dt. 07 qershor 2023, për pezullim të gradimeve APP të dy KTA;
- Vendimi 05/ZDP/VE/2023, i dt. 07 qershor 2023, për revokim të licencës së KTA;
- Vendimi 06/ZDP/VE/2023, i dt. 22 gusht 2023, për zbatim në rendin juridik të CS/AMC/GM në fushën e aerodromeve;
- Vendimi 07/ZDP/VE/2023, i dt. 12 shtator 2023, për revokimin e gradimeve të kontrollorit të trafikut ajror;
- Vendimi 08/ZDP/VE/2023, i dt. 27 shtator 2023, për zbatim në rendin juridik të CS/AMC/GM në fushën e shërbimit të navigimit ajror;
- Vendimi 09/ZDP/VE/2023, i dt. 10 tetor 2023, për shfuqizim të Vendimit 05/ZDP/VE/2023;
- Vendimi 10/ZDP/VE/2023, i dt. 31 tetor 2023, për shfuqizim të masës së për pezullim të gradimeve APP sipas Vendimit 04/ZDP/VE/2023;
- Vendimi 11/ZDP/VE/2023, i dt. 20 dhjetor 2023, për caktim të tarifës terminale të ASHNA-s 2024; dhe
- Vendimi 12/ZDP/VE/2023, i dt. 29 dhjetor 2023, për lejim të të drejtave të trafikut për kompanitë me AOC të Shqipërisë dhe Zvicrës.

## **2. CERTIFIKIMI I OPERATORËVE, LICENCIMI I PERSONELIT DHE MBIKËQYRJA E VAZHDUESHME**

### **2.1 Certifikimi i operatorëve të aviacionit**

Bazuar në kërkesat legjislative nuk ka pasur asnjë planifikim për certifikim/aprovim të operatorëve nën mbikëqyrjen e AAC-së. Në të njëjtën kohë gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur kërkesa për certifikim/aprovim nga operatorë të rinjë.

### **2.2 Licencimi i personelit të aviacionit (licencimi i kontrollorëve dhe paragllajdistëve, lëshimi i certifikatave mjekësore, etj.)**

#### **a) Licencimi i kontrollorëve**

AAC-ja edhe gjatë vitit 2023 ka vazhduar me përgjegjësitë ligjore për lëshimin dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbimet e kontrollit ajror në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror në sigurinë e fluturimeve, kontrollorët duhet të përmbushin një varg të kërkesave dhe kushteve për të mirëmbajtur licencat dhe miratimet e tyre, të cilat dalin nga Rregullorja nr. 19/2017 e AAC-së që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Kërkesat kryesisht ndërlidhen me nivelin e kompetencës profesionale, që përfshijnë ndjekjen e trajnimeve profesionale përditësuese dhe ushtrimin e detyrave të kontrollorit të trafikut ajror për një numër të caktuar të orëve brenda vitit. Kontrollorët gjithashtu, në baza vjetore, i nënshtrohen vlerësimit profesional për të verifikuar nivelin e aftësive. Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zotërimit të gjuhës angleze, pasi që komunikimi në aviacionin ndërkombëtar bëhet në këtë gjuhë. Niveli i zotërimit të gjuhës angleze vlerësohet në mënyrë periodike dhe merret parasysh gjatë lëshimit apo ripërtëritjes së licencës. Kontrollorët gjithashtu duhet të kenë shëndet të mirë, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kjo verifikohet në mënyrë të rregullt nga AAC-ja si pjesë e procesit të licencimit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë rivalidimi i licencave për 22 KTA-të, pasi që janë plotësuar kushtet e parapara në Rregulloren 19/2017 për licencimin e KTA-ve.

Gjatë vitit 2023 është revokuar licenca me nr. CAA033, për arsye shëndetësore, si dhe janë suspenduar gradimet APP për dy licenca, ajo me nr. CAA001 dhe nr. CAA015, për shkak të përfshirjes në incidentin e datës 24.02.2023. Licencës me nr. CAA015 i janë revokuar gradimet APP dhe APS, pas kërkesës vullnetare të mbajtësit të licencës. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është lëshuar rekomandimi nga departamenti i SHNA-së, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me tërheqjen e revokimit, pasi AME ka konfirmuar lëshimin e licencës mjekësore për licencën me nr. CAA033.

Detajet me licencat e ripërtërira dhe rivalidim të gradimeve, për vitin 2023, është dhënë në tabelën e mëposhtme.

<b>Licencimi i Kontrollorëve të Trafikut Ajror (KTA)</b>	<b>Numri i të licencuarve</b>
Ripërtëritja e licencave për KTA (miratimeve të njësisë)	22
Licencim i KTA-ve të rinjë	0
Rivalidimi i miratimeve të gjuhës	0
Rivalidim/ripërtëritje e gradimeve për instruktorë/asesorë	0
Licencimi i studentëve KTA	0
Suspendim i licencave për KTA	3

#### ***b) Lëshimi i licencave për paragllajdistë***

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur aktivitete sa i përket licencimit të paragllajdistëve.

#### ***c) Lëshimi i certifikatave mjekësore dhe certifikimi I AME-së***

- Në periudhën nga 18 janari dhe më 14 dhjetor 2023 në Qendrën Aero-mjekësore në Gjakovë (AeMC) janë kryer tridhjetë e dy (32) ekzaminime mjekësore për kontrollorë të trafikut ajror të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror (ASHNA), me qëllim të vazhimit të vlefshmërisë së certifikatave mjekësore të klasës 3.
- Më datë 10 shkurt 2023, Dr. Naim Bardiqi ka paraqitur kërkesën në Sektorin e Mjekësisë së Aviacionit (AMS) për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së tij për AME. Më datë 16 shkurt 2023 pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së aplikimit të Dr. Naim Bardiqit për vazhdimin e certifikimit në cilësinë e mjekut AME, u vlerësua se Dr. Bardiqi në bazë të legjislacionit në fuqi, plotëson kriteret për vazhdimin e certifikimit si mjek AME dhe si rezultat iu lëshua certifikata AME edhe për tre (3) vite të tjera.

### **2.3 Lëshimi i lejeve për fluturimet VFR dhe ato diplomatike, për mallrat e rrezikshme, për operimet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron)**

#### ***a) Lëshimi i lejeve për fluturimet VFR***

Gjatë vitit 2023 Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve përbrenda AAC-së ka lëshuar gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) aprovime për fluturim sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR). Të gjitha këto



aprovime janë lëshuar në koordinim të ngushtë me njësitin ajror të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3Air).

**b) Lëshimi i lejeve për Fluturime diplomatike**

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2023 ka pranuar njëqind e një (**101**) kërkesa për fluturime diplomatike të dërguara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës. Të njëjtat janë proceduar tek njësitit ajror i Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3Air) për aprovim. Kërkesat e aprovuara janë proceduar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës për fluturime Diplomatike në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

**c) Lëshimi i lejeve për mallrat e rrezikshme**

Kompanitë ajrore dhe numri i lejeve për transport të mallrave të rrezikshme nga ajri gjatë vitit 2023 është paraqitur në tabelën më poshtë:

<b>Kompania Ajrore</b>	<b>Numri i Lejeve të lëshuara</b>
Turkish Airlines	134
Pegasus Hava Tasimaciligi	38
Austrian Airlines	28
National Air Cargo Group	3
CAVOK Air	1
MNG Airlines	1
<b>Totali</b>	<b>205</b>

**d) Lëshimi i lejeve për operimet me sistemet të mjeteve ajrore pa pilot**

AAC në bazë të përgjegjësisë ligjore bënë regjistrimin e mjeteve ajrore pa pilot ndërsa procesi i marrjes së lejeve për operime me këto mjete bëhet nëpërmes AShNA.

**2.4 Aprovimi i fluturimeve për mjetet e huaja ajrore civile**

Gjatë periudhës së raportimit, AAC ka lëshuar aprovimet të fluturimeve për mjetet e huaja ajrore civile, si në vijim:

- 31 leje sezonale;
- 194 leje për fluturime ad-hoc; dhe
- 4 leje për fluturime private (kohëzgjatja 6 muaj).

**2.5 Regjistrimi i operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP/dronëve) dhe nxjerra e vendimeve për operimet e paautorizuara me këto sisteme**

**a) Regjistrimi i operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP/dronëve)**

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve përbrenda AAC-së gjatë vitit 2023 ka regjistruar dyzet e katër (44) aplikues të rinj për operime me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Po ashtu janë aprovuar edhe gjashtë (6) operatorë të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot të regjistruar në vende të tjera. Aprovimi i

operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, është bërë në koordinim të ngushtë me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR J3-Air).

Në vazhden e aktiviteteve rregullatore të parapara me legjislacionin në fuqi Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve organizoi provimin për testin e njohurive për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (dronëve) të Kategorive të ndryshme. Këtij provimi i janë nënshtruar tre (3) kandidatë të cilët i kanë kaluar me sukses këtë testim.

#### ***b) Nxjerra e vendimeve për operimet e paautorizuara me sistemet e mjeteve ajrore pa pilot***

Në përputhje me Rregulloren (AAC) Nr. 01/2017 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP), të përditësuar, gjatë vitit 2023, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka lëshuar gjithsejtë dhjetë (10) vendime për shqiptimin e gjobave për shkeljet në lidhje me operimet e paautorizuara me dronë (SAP). Po ashtu, janë lëshuar edhe faturat përkatëse dhe pas kryerjes së pagesave nga palët e gjobitura, është udhëzuar Policia e Kosovës për lirim të dronëve të konfiskuar.

## **2.6 Mbikëqyrja e vazhdueshme e operatorëve dhe mbikëqyrja e brendshme**

#### ***a) Auditimet/inspektimet e sigurisë në fushën e shërbimeve të navigacionit ajror (operatori ASHNA)***

ASHNA është certifikuar si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror për herë të parë më 19 gusht 2016 dhe ricertifikuar më 19 gusht 2021. Departamenti i SHNA-së është përgjegjës për të mbikëqyrur mirëmbajtjen dhe respektimin e kushteve të certifikatës nga ana e ASHNA-s, përmes auditimeve të rregullta, vizitave dhe inspektimeve ad-hoc.

Gjatë vitit 2023, AAC ka realizuar dy audite në këtë fushë, sipas planifikimeve vjetore për audite, një audit ad-hoc, një auditim për disa ndryshime të njoftuara si dhe auditin e ASHNA-s nga ICETRA, duke verifikuar njëherit përmbushjen e kërkesave rregullative.

- *Auditimi në periudhën 27-31 mars 2023*
- *Auditimi i pa-planifikuar i datës 10 maj 2023*
- *Auditimi në periudhën 17-21 korrik 2023*
- *Auditimi për disa ndryshime të njoftuara*
- *Auditimi i ASHNA-s nga ICETRA*

#### ***b) Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s***

Gjatë vitit 2023, AACK ka trajtuar ndryshimet si më poshtë:

- **Ndryshimi CH-2023-01 “AHMS”**

Me 22.02.2023, ASHNA ka njoftuar ndryshimin AHMS (Automatic Message Handling System). Ndryshimi është klasifikuar nga ana e SHNA-së si ndryshim i cili kërkon rishikim dhe aprovim para implementimit si dhe do t'i nënshtrohet rishikimit të plotë nga SHNA.

- **Ndryshimi CH-2023-02 “Ndryshimet në MANOPS”**

Me 29.03.2023, ASHNA ka njoftuar ndryshimin e ri në lidhje me “Ndryshimet në MANOPS”. Në bazë të kërkesës së rregullore 09/2020, kërkohet aprovimi para implementimit të ndryshimeve të cilat kanë të bëjnë me procedurat e operimit.

Me 15.08.2023, është pranuar dokumenti “Approval of entry into operation”, ndërsa me 16.08.2023 dokumentet si “Read and Understood” dhe “LIN 008”.

Ky ndryshim u pranua nga SHNA me 16.08.2023.

- **Ndryshimi CH-2023-03 “Rikonstruktimi i salles APP/ACC”**

Me 12.10.2023 është pranuar njoftimi për ndryshimin Rikonstruktimi i sallës APP/ACC. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, ndryshimi u klasifikua si ndryshim i cili nuk kërkon aprovim paraprak nga SHNA dhe i cili nuk ka nevojë për rishikim andaj ASHNA ka vazhduar me procedurën e tyre për implementim në lidhje me këtë lloj të ndryshimit.

- **Ndryshimi CH-2019-05 “New flight progress strip”**

Me 07.11.2019, ASHNA ka njoftuar ndryshimin në lidhje me Ndryshimin e formatit të flight progress strip.

ASHNA ka kërkuar nga SHNA që të bëhet një dosje e cila do të përfshinte Vlerësimin e plotë të Sigurisë, Planet e veprimeve me dokumentet sipas procedurës.

Në janar të vitit 2020 është pranuar Vlerësimin e sigurisë version 1.1 si dhe Koncept Dokumentin për këtë ndryshim.

Duke marrë parasysh që ky ndryshim ka paraparë përditësimin e proceseve dhe procedurave në MANOPs, deri në fillim të vitit 2023 nuk ka pasur ndonjë aktivitet konkret për këtë ndryshim, kur edhe është bërë njoftimi i ndryshimit “CH-2023-02-Ndryshimet në MANOPs”.

Si rrjedhojë, ASHNA me datë 09 gusht 2023 ka bërë kërkesë për miratimin e këtij ndryshimi dhe ka dërguar planin e sigurisë dhe vlerësimin e rishikuar të sigurisë Version 1.2 datë 08.08.2023.

Me datë 10 gusht 2023 departamenti i SHNA-së ka realizuar një audit të dedikuar për këtë ndryshim, ku qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i mbarëvajtjes së implementimit të këtij ndryshimi si dhe përmbushja e rekomandimeve të sigurisë të dala nga vlerësimet e sigurisë.

Gjatë këtij auditit, është vërejtur se rekomandimet e sigurisë të dala nga vlerësimet e sigurisë janë përmbushur si dhe është bërë një vizitë në pozita operuese për të verifikuar nga afër këtë ndryshim.

Për më shumë SHNA ka kërkuar nga ASHNA që të dërgojnë edhe dokumentin e nënshkruar për gatishmërinë për operim. Ky dokument është dërguar nga ASHNA me datë 15 gusht 2023.

Si rrjedhojë, Departamenti i SHNA-së ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, dhe ka vërejtur se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi dhe ka konfirmuar pranimin e ndryshimit “**Ndryshimi i formatit të Flight Progress Strips**”, më datë 16 gusht 2023.

- **Ndryshimi “Sistemi i ri i Survejimit”**

Ndryshimi “Sistemi i ri i Survejimit”, është njoftuar si ndryshim me 31.01.2018 dhe i njëjti ishte klasifikuar si ndryshim madhor, sipas procedurës në fuqi për ndryshime në atë kohë.

Me 09.12.2022 përmes një emaili ASHNA ka paraqitur kërkesën për aprovimin e ndryshimit PSF18-005-SAA Sistemi i ri i Survejimit, i cili është instaluar në lokacionin e Aeroportit të Gjakovës.

Me 16.02.2023, SHNA realizoj edhe një vizitë në ASHNA, me ç’rast u verifikua implementimi i rekomandimeve të dala nga Vlerësimi i Sigurisë.

Në kuadër të kësaj vizite u kërkuar që të dërgohen dëshmi në lidhje me kapacitetin e linjës së komunikimit ASHNA-GOLESH, ofruar nga operatori I IPKO-s.

Përdorimi i plotë i të dhënave në Mode S ndërlidhet me pranimin e ndryshimit Rilokimi dhe Azhurnimi i APP/TWR, për të cilin SHNA ka pritur informata shtesë nga ASHNA.

Me datë 13.07.2023, këto informata janë pranuar nga ASHNA dhe Departamenti i SHNA-së ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar, përfshirë edhe evidencat shtesë.  
Ky ndryshim u pranua më datë 14 korrik 2023.

- **Ndryshimi “Rilokimi dhe Azhurnimi i APP/TWR”**

Me 20.02.2023, ASHNA ka dorëzuar kërkesën për aprovimin e ndryshimit PSF18-007-SAA-Rilokimi dhe azhurnimi i APP/TËR.

Takim me ASHNA në lidhje me këtë ndryshim, u mbajt me 03.03.2023, me ç ‘rast u diskutua për pranimin e këtij ndryshimi së bashku me mundësinë e integritit të dhënave të Radarit të Gjakovës. SHNA ka kërkuar disa dokumente shtesë, të cilat u dërguan me datë 13.07.2023.

Ndryshimi u pranua me 14.07.2023.

- **Ndryshimi CH/2018/08 , pjesa për furnizim me energji elektrike**

Ky ndryshim i referohet ndryshimit CH/2018/08 të njoftuar përmes formës (AACK/SHNA/NSA-FRM 02) të dërguar nga ASHNA më 22 maj 2018 në lidhje me zgjatjen dhe ngritjen e kapaciteteve të pistës, ku pjesë e tij kanë qenë të përfshira edhe sistemet për furnizim me energji elektrike dhe monitorim për pajisjet e përfshira në këtë ndryshim.

Departamenti i SHNA-së ka mbikëqyrur vazhdimisht implementimin e këtij ndryshimi madhor, si gjatë auditimeve të planifikuara ashtu edhe me anë të auditëve ad-hoc dhe inspektimeve.

SHNA nga data 03 deri me 07 gusht 2020 ka realizuar një audit gjithëpërfshirës në ASHNA për të audituar këtë ndryshim. Gjatë auditit, për secilin sistem është konfirmuar statusi i implementimit, si dhe është verifikuar përmbushja e rekomandimeve të dala nga vlerësimet e sigurisë. Për detaje shih raportin me titull “Raporti i Auditimit të Sigurisë, i realizuar në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, 03-07 gusht 2020 AACK/SHNA/AUDIT/1-23”.

Me datë 04 maj 2023, ASHNA ka dërguar dokumentacion shtesë për këtë ndryshim si në vijim:

- Planin e sigurisë (plani i veprimt dhe zbatimi i masave mitiguese nga SAA), DOV dhe
- EC Declaration, SAT (për objekt, Sistemin e monitorimit dhe Rrjetin e kabllimit), Trajnimet, Hartat e shtrirjes se kabllimit si dhe Specifikimet teknike.

Me datë 10 maj 2023 departamenti i SHNA-së ka realizuar një audit të dedikuar për këtë ndryshim, ku qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i mbarëvajtjes së implementimit të këtij ndryshimi si dhe përmbushja e rekomandimeve të sigurisë të dala nga vlerësimet e sigurisë.

Gjatë këtij auditit, është vërejtur që sistemet janë instaluar dhe rekomandimet e sigurisë të dala nga vlerësimi i sigurisë janë përmbushur, por është kërkuar nga ASHNA që të dërgojnë edhe dokumentacionin që ka të bëjë me mirëmbajtjen e këtyre sistemeve dhe dokumentin e nënshkruar për gatishmërinë për operim. Këto dokumente janë dërguar nga ASHNA me datë 20 korrik 2023 respektivisht me datë 11 gusht 2023.

Si rrjedhojë, Departamenti i SHNA-së ka rishikuar në tërësi dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA, dhe ka vërejtur se i gjithë dokumentacioni është kompletuar dhe konform rregulloreve në fuqi.  
Ky ndryshim u pranua më datë 14 gusht 2023.

- c) **Mbikëqyrja e ASHNA-s si Organizatë Trajnuese (OT)**

ASHNA është certifikuar më 19 dhjetor 2017 nga AAC-ja për një periudhë 3 vjeçare për të ofruar shërbimet që i takojnë një Organizate Trajnuese për Kontrollorët e Trafikut Ajror (KTA) siç janë: trajnimet për njësi për KTA dhe trajnimet e vazhdueshme për KTA.

Procesi i certifikimit ka filluar në vitin 2016 kur ASHNA ka aplikuar për certifikim. Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 19/2017 të AAC-së e cila zëvendësoi Rregulloren nr. 05/2012, në bazë të së cilës asokohe

u certifikua ASHNA si OT, AAC u obligua që të bëjë zëvendësimin e certifikatës aktuale në formatin e ri të përcaktuar në Rregulloren nr. 19/2017. Në përputhje me këtë kërkesë, AAC më 04.01.2019 ka zëvendësuar certifikatën e lëshuar në vitin 2017, me certifikatën CAAK/ANS/1-2019, sipas formatit të ri të paraparë me rregulloren e lartpërmendur.

Që nga koha e certifikimit, ASHNA OT është audituar disa herë përgjatë këtyre viteve nga Departamenti i SHNA-së, brenda kornizave të procesit të mbikëqyrjes së vazhdueshme, për të garantuar dhe verifikuar se OT vazhdon të plotësojë të gjitha kërkesat e rregullores.

Lëshimi i Certifikatës dëshmon për sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara por që kërkon angazhim të vazhdueshëm nga ana e ASHNA-s për respektimin e kushteve të certifikimit dhe për ngritje edhe më tutje të cilësisë së shërbimeve.

Gjatë vitit 2023, janë zhvilluar aktivitete përcjellëse për gjetjet që kanë qenë të hapura në auditet e mëparshme.

## **2.6.2 Auditimet/inspektimet e sigurisë në fushën e aerodromeve**

### **a) Auditimi/Inspektimet e ANP “Adem Jashari” LKIA dhe auditimet/inspektimet e sigurisë të shërbyesve në tokë**

Sipas Ligjit Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, që ndryshon Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, AAC është përgjegjëse për rregullimin dhe zhvillimin e politikave të aerodromeve, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe organizatave trajnuese duke verifikuar zbatimin e standardeve të aplikueshme të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe duke siguruar një ambient të sigurt të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Varësisht nga natyra e operimeve dhe shkalla e shfrytëzimit, aerodromet civile kategorizohen në aerodrome të certifikuar, aerodrome të aprovuara dhe aerodrome të regjistruara. Në kuadër të AAC-së, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për certifikim, aprovim dhe regjistrim të aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim civil në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe fushat ajrore dhe heliportet. Me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave që rregullojnë qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është poashtu përgjegjës për aprovimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë së ofruesve të shërbimeve në tokë në aerodromet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve në tokë për furnizim të aeroplanëve me karburant.

Gjithashtu, për t'u siguruar se aftësimi profesional dhe trajnimi i punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vetë japin shërbime në tokë, bëhet sipas standardeve dhe kriterëve të përcaktuara me legjislacionin përkatës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për certifikim të organizatave të aftësimi profesional në fushën e aerodromeve.

Me qëllim të mirëmbajtjes së sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për caktimin dhe monitorimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve. Ky departament koordinon bashkëpunimin mes operatorëve të aerodromeve, departamentit përgjegjës në ASHNA, subjekteve juridike/personave fizik, të cilët kanë në pronësi apo planifikojnë të ndërtojnë një objekt brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve apo ndonjë objekt të lartë kudo në territorin e Republikës së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit sipas Ligjit për ndërtim. Departamenti i aerodromeve duhet të sigurojë që të gjitha palët e përfshira i respektojnë dispozitat dhe procedurat e përshtuara në rregulloren mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe rregulloren për shënjimin e pengesave.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” fillimisht është certifikuar më 1 dhjetor 2008 nga AAC-ja si aeroport ndërkombëtar në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil, Rregulloren e AAC-së nr. 1/2008 për aerodromet dhe standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s. Në vitin 2011 aeroporti

është dhënë në koncesion dhe menaxhimi i tij ka kaluar në duart e operatorit privat, konzorciumit turko-francez “Limak - Aéroports de Lyon” (Limak Kosovo International Airport sh.a.). Më 8 nëntor 2013, bazuar në kërkesat ligjore, me rastin e transferimit të operimeve në terminalin e ri, AAC-ja ka amandamentuar certifikatën e operatorit “Limak Kosovo International Airport“ sh.a. (LKIA). Më tej, pas hyrjes në fuqi të Rregullores nr. 17/2017 të AAC-së që përcakton dispozitat dhe procedurat administrative lidhur me aerodromet, që e ka zbatuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 139/2014 me të njëjtin emër, më 8 nëntor 2018, AAC-ja ka certifikuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe operatorin e aerodromit “Limak Kosovo International Airport” sipas standardeve më të larta të sigurisë së aerodromeve dhe në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian. Përfundimisht, me finalizimin e projektit infrastrukturor të zgjatjes së pistës nga 2.500 në 3.040 metra, së bashku me ngritjen e kategorisë për operim me sistemin preciz të aterimit, me 21.12.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ka lëshuar certifikatën e operimit për kod referent të aerodromit 4E, bazuar në karakteristikat dhe performancën e aeroplanëve më të mëdhenj që janë planifikuar të operojnë në ANP “Adem Jashari”.

Në bazë të Rregullores nr. 4/2011 të AAC-së për qasje në tregun e shërbimeve në tokë, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 5/2019, më 1 janar 2012 AAC-ja ka lëshuar aprovimin për kompaninë “ExFis” Sh.P.K. si furnizues i shërbimeve në tokë për kategorinë e shërbimeve të furnizimit me derivate dhe vajra, kurse me 1 qershor 2012, është aprovuar operatori LKIA për ofrim të shërbimeve në tokë në disa kategori në ANP “Adem Jashari”.

Një nga funksionet themelore të Departamentit të Aerodromeve, për garantimin e sigurisë së aerodromeve në Republikën e Kosovës, është zbatimi i sistemit efektiv të mbikëqyrjes. Mbikëqyrja efektive e sigurisë bëhet përmes vlerësimit dhe aprovimit të manualeve, programeve dhe procedurave të ndryshme të operatorit, miratimeve të vlerësimeve të sigurisë, dhe veçanërisht përmes kryerjes së auditimeve dhe inspektimeve formale (me apo pa njoftim paraprak të operatorit), bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes, apo duke iu përgjigjur situatës që mund të kërkojë nevojën për vigjilencë shtesë në siguri.

Sipas planit të aktiviteteve për monitorimin e rregullt dhe verifikimin e zbatimit të standardeve të aplikueshme për operatorin e ANP "Adem Jashari" dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, inspektorët e Departamentit të Aerodromeve gjatë vitit 2023 kanë përmbushur plotësisht planin e mbikëqyrjes së sigurisë për këtë vit, duke realizuar:

- Katër (4) inspektime të planifikuara sipas planit vjetor të mbikëqyrjes, dy prej të cilave janë për ofruesit e shërbimeve në tokë;
  - Një (1) auditim i cili i është referuar Vendimit Nr. 06/ZDP/VE/2023, në lidhje me zbatimin e mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese të miratuara nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA), dhe bazuar në standardet e ndryshuara pas krijimit të Bazës së Operacioneve (OB), për ti rivendosur OB sipas legjislacionit në fuqi;
  - Katër (4) inspektime “ad-hoc” që nuk janë planifikuar paraprakisht në planin e mbikëqyrjes por janë realizuar si përgjigje ndaj çështjeve të ndryshme sigurie; dhe
  - Dy (2) inspektime tjera, jashtë aeroportit, për të verifikuar zbatimin e kërkesave për shënjim të objekteve të larta në përputhje me dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 09/2018 për zonat mbrojtëse të aerodromit.
- 
- **Mirëmbajtja e hapësirave në rrethinë të ANP “Adem Jashari”**

Në vazhden e komunikimit të vazhdueshëm mes të AAC-së, përfaqësuesve të komunave të Lipjanit dhe Fushë Kosovës dhe përfaqësuesve të operatorit LKIA lidhur me mirëmbajtjen e kanaleve kulluese jashtë rrethojës së Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” e që janë në kompetencën e Komunës së Lipjanit dhe Komunës së Fushë Kosovës, gjatë muajit qershor inspektorët e AAC kanë realizuar takimet me zyrtaret përgjegjës të komunave përkatëse.

Me 07.06.2023 janë realizuar takimet me Drejtorin e drejtorisë së urbanizmit dhe Drejtorin e drejtorisë së shërbimeve publike të Komunës së Fushë Kosovës, ku është diskutuar mirëmbajtja e kanaleve kulluese. Në takim, zyrtarët e Fushë Kosovës kanë shprehur gatishmëri për të trajtuar me prioritet pastrimin e kanaleve që kalojnë në komunën e tyre.

Me date 27.06.2023 është realizuar takimi me nënkryetarin e KK Lipjanit, ku është diskutuar për pastrimin e kanaleve për rreth aeroportit dhe që shtrihen në territorin e KK Lipjanit.

Me date 27.07.2023 është kontaktuar në telefon nënkryetari i KK Lipjanit, për të biseduar për hapat që janë duke i ndërmarr lidhur me pastrimin e kanaleve si rrjedhojë e takimit të datës 27.06.2023.

Po ashtu me date 26.07.2023 është kontaktuar edhe drejtori i urbanizmit të KK F. Kosovës, ku është kërkuar që të njoftoj AAC, për ndonjë veprim që është ndërmarr lidhur me pastrimin e kanaleve për rreth zonës së aeroportit.

- **Zgjerimi i terminalit të ANP “Adem Jashari” për të rritur kapacitetin dhe cilësinë e shërbimit**

Gjatë kësaj periudhe, është pranuar kërkesa nga LKIA për pëlqim të AAC-së për projektin e zgjerimit të terminalit të ANP “Adem Jashari”, për të rritur kapacitetin dhe cilësinë e shërbimit. LKIA ka dorëzuar për aprovim edhe projektin e detajuar, së bashku me vlerësimin e rrezikut. Pas pranimit të konfirmimeve të nevojshme nga operatori, AAC ka konfirmuar se realizimi i projektit mund të vazhdojë sipas planit të prezantuar. Ndërtimi është duke u bërë në dy anët e terminalit.

- **Ushtrimi gjithëpërfshirës sipas planit emergjent, i agjencive reaguese brenda dhe jashtë aeroportit**

Sipas Planit Emergjent të LKIA-së, çdo dy vjet duhet mbahet një ushtrim gjithëpërfshirës i agjencive reaguese brenda dhe jashtë aeroporti. Në vazhden e këtyre përgatitjeve departamenti i aerodromeve gjatë kësaj periudhe është takuar për ta analizuar çështjet e ngritura pas përfundimit të ushtrimit gjithëpërfshirës të vitit 2021 dhe për të koordinuar veprimet për organizim të ushtrimit për vitin 2023. Me datë 27.09.2023 kemi pranuar konfirmim nga LKIA që ushtrimi gjithëpërfshirës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” do të mbahet në mesnatë të datës 24-25 Tetor 2023.

Ushtrimi gjithëpërfshirës është zhvilluar sipas planit, ndërsa AAC është përfaqësuar me 9 vëzhgues në pikat e ndryshme, në harmoni me direktivën e ushtrimit dhe sipas Planit Emergjent të ANP-së. Bazuar në të dhënat e mbledhura gjatë vëzhgimeve, është konstatuar se në shumicën e pikave ushtrimi ka arritur efektin dhe qëllimin e tij. Është verifikuar gatishmëria e shumicës prej agjencive të përfshira në reagim në emergjenca, sipas planit emergjent të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Mirëpo, janë identifikuar edhe disa mangësi që duhen të analizohen dhe të korrigjohen në të ardhmen, që është edhe qëllimi i ushtrimit.

- **Projekti i LKIA-së për rindërtimin e shiritit të pistës në ANP “Adem Jashari”**

Siç kërkohet me Rregulloren nr. 17/2017 për aerodrome dhe në përputhje me materialin udhëzues TP 27 – “Procedurat për ndryshime të aerodromit”, në muajin Shkurt të vitit 2023, AAC ka pranuar dokumentacionin lidhur me implementimin e projektit për rindërtimin e shiritave të pistës (*runway strip*), për të përmbushur kërkesën nga procesi i certifikimit të ANP “Adem Jashari”, të regjistruar si DAAD (“Dokumentimi për pranimin e devijimit dhe veprimin” - ‘*Deviation Acceptance and Action Document*’). Pas rishikimit dhe analizimit të kërkesës për ndryshim dhe pas konsultimeve të vazhdueshme me operatorin, aplikacioni është aprovuar nga AAC. Implementimi i fazës së parë të projektit ishte planifikuar të fillojë në muajin prill, mirëpo për shkak të kushteve atmosferike dhe sezonit të operimeve, projekti ka filluar të implementohet në muajin shtator dhe është ndërpre në muajin nëntor. Vazhdimi i punimeve është planifikuar në muajin prill 2024.

**b) Auditimet/inspektimet e organizatave trajnuese në fushën e aerodromeve dhe të ofruesve të shërbimeve në tokë**

Gjatë këtij viti, operatori LKIA ANP "Adem Jashari" ka dërguar për aprovim ndryshimet e fundit të Manualit të operimit të organizatës për aftësi profesionale. AAC ka rishikuar dhe analizuar dokumentin, kurse pas përfshirjes të të gjitha komenteve, versioni i ri i Manualit të operimit të organizatës për trajnime profesionale, është miratuar nga AAC. Departamenti i Aerodromeve në mënyrë vazhdueshme monitoron dhe verifikon punën e organizatës dhe instruktoreve në përputhshmëri me kushtet e certifikatës dhe legjislacionit në fuqi.

**c) Implementimi i Rregullores për shenjzimin e pengesave**

**• Shënjimi dhe ndriçimi i pengesave në Golesh**

Bazuar në Rregulloren (AAC) Nr. 03/2019 për shenjimin e pengesave, shënjimi dhe mirëmbajtja e shenjave dhe dritave të pengesave do të kryhet nga pronarët, poseduesit dhe/ose operatorët e pengesës. Në Tetor të viti 2023 u realizua një inspektim për verifikimin për kontrollin dhe mirëmbajtjen e dritave të pengesave në turbinat me erë si dhe antenat e ndryshme që gjenden në kodrën e Goleshit. Nga verifikimi në terren rezultoi se dritat e pengesave të aviacionit në të tri turbinat e erës nuk janë funksionale. Megjithatë dritat e pengesave përfshihen në inspektimet e rregullta të komponentëve të turbinës së erës, nuk gjetëm asnjë provë që siguronte mirëmbajtjen e rregullt parandaluese të dritave të pengesave. Sa i përket antenave tjera të larta, u verifikua se të gjitha antenat që janë në pikat më të larta kanë në funksion dritat e pengesave të aviacionit (obstacle lights).

**• Shënjimi i linjave transmetuese - KOSTT**

Për të bërë verifikimin e implementimit të Rregullores 03/2019 për Shënjimin e pengesave, sipas planit të veprimit për vitin 2023, është vazhduar përcjellja e zbatimit të planit të kompanisë KOSTT për shënjim vizual të linjave 400/220/100 kV të cilat gjenden në kryqëzim të autostradës "Ibrahim Rugova", në aksin rrugor (R7) Arllat – Prizren, dhe autostradës "Arbër Xhaferi" në aksin rrugor (R6) Prishtinë – Hani Elezit.

Shënjimi i largpërçuesve të kompanisë KOSTT përfshinë:

1. Vendosijen e sferave në kablo,
2. Vendosijen e dritave sinjalizuese në shtylla,
3. Ngjyrosjen e shtyllave (kuq dhe bardh).

Përgjatë vitit 2023 inspektorët e aerodromeve, kanë realizuar dy inspektime në terren, në Autostradën "Ibrahim Rugova" - aksi rrugor (R7) Arllat – Prizren, për të verifikuar implementimin e projektit "Shënjimi i pengesave" për shtyllat e linjave transmetuese të KOSTT-it në pikat ku kalojnë sipër autostradës. Inspektimet ishin vazhdimësi e procesit të verifikimit të implementimit të punimeve lidhur me këtë projekt të planifikuar për vitin 2021/2022 e që ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023.

Pas analizimit të raporteve të pranura dhe verifikimit në terren, inspektorët e aerodromeve kanë konstatuar se implementimi i projektit për shënjimin e pengesave për pozicionet e realizuara deri me tani është kryer sipas kërkesave të Rregullores (AAC) Nr. 03/2019.

Përpos inspektimeve në terren, në muajin Mars 2023 është realizuar takimi me përfaqësuesit të KOSTT, dhe janë diskutuar planet e veprimit për implementimin e kërkesave të Rregullores se AAC 03/2019. Gjate diskutimeve AAC ka kërkuar nga përfaqësuesit e KOSTT që të përpilohet një plan dinamik lidhur me zbatimin e rregullores në fjalë në tërë territorin e Kosovës, për të gjitha objektet dhe linjat të cilat janë në përgjegjësi të KOSTT-it. Gjithashtu KOSTT, duhet të bëjë monitorimin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e shenjzimit dhe të ndriçimit të linjave të realizuara deri më tani, në përputhje me nenet 3.8 dhe 20 të rregullores (AAC) 03/2019 për Shënjimin e Pengesave.



Përfaqësuesit e KOSTT u zotuan për vazhdimin e projektit duke konsideruar edhe aprovimet nga ZRRE dhe nga menaxhmenti i lartë. Lidhur me këtë, në takim është dakorduar edhe nevoja për mbajtjen e një takimi në nivel të lartë në mes të AAC dhe KOSTT, që është dokumentuar edhe me shkrim përmes minutave të takimit.

Inspektorët e aerodromeve ka vazhduar komunikimin e ngushtë me përfaqësuesit e KOSTT-it lidhur me projektin e shënjitimit vizual të linjave 400/220/100 kV, duke bërë tentativa të vazhdueshme për aranzhim të një takimi ndërinstitucional.

***d) Vlerësimet aeronautike për ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve, si dhe objekteve të larta në territorin e Republikës së Kosovës (veçanërisht të turbinave të erës)***

Departamenti i aerodromeve ka vazhduar të ushtrojë rolin koordinues për vlerësimin e ndikimit të ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës.

Sipas Ligjit Nr. 03 / L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores (AAC) nr. 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores (AAC) Nr. 03/2019 për Shënjitimin e pengesave, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është përgjegjës për të siguruar se të gjitha objektet, të palëvizshme apo të lëvizshme, që gjenden brenda një hapësire me rreze prej 15 km prej një aerodromi apo objekte të larta që mund të konsiderohen si pengesa për aeroplanët në fluturim jashtë kësaj hapësire, janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit aeronautik gjithëpërfshirës nga ana e operatorit të ANP “Adem Jashari” (LKIA) dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA). Varësisht nga rezultatet e vlerësimeve, AAC do të konstatoj se a paraqet pengesë një objekt apo jo, dhe mund të kërkoj nga aplikuesi që të zbatoj procedurat për shënjitimin (me ngjyrosje dhe/apo ndriçim) e objekteve, me qëllim për të ngritur sigurinë e fluturimeve, duke i bërë pengesat të dallueshme nga zona përreth dhe të dukshme nga të gjitha drejtimet për aeroplanët.

***• Vlerësimi i ndikimit, të turbinave të erës dhe ndërtimeve të larta, në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës***

Duke i koordinuar veprimet nën përgjegjësinë e saj, AAC duhet të sigurohet se ndërtimi, instalimi dhe operimi i turbinave të erës nuk do të ndikojë në sigurinë e operimeve të aeroportit dhe në trajektoret e fluturimeve të aeroplanëve në Republikën e Kosovës.

Në shtator të vitit 2023, inspektorët e aerodromeve kanë realizuar në Selac, Bajgorë, një inspektim të operatorit/pronarit të turbinave të erës “SOWI Kosovo L.L.C/ NOTUS energy Plan GmbH & Co. KG”. Qëllimi i inspektimit ishte të verifikohet implementimi i kërkesave të Rregullores (AAC) 03/2019 për shënjitimin e pengesave, me theks të veçantë në mirëmbajtjen e ndriçimit të pengesave. Inspektimi ka rezultuar i suksesshëm, duke konfirmuar përkushtimin e operatorit për ti përmbushur obligimet nga rregullorja e AAC.

Po ashtu në muajin Nëntor të vitit 2023 është pranuar një kërkesë nga operatori “StubllaEnergy SH.P.K” për vlerësim aeronautik të vendosjes së shtyllës me pajisje për matje të karakteristikave të erës, si pjesë e projektit të parkut energjetik me mullinj të erës që parashihet të ndërtohet në Jasenovik, Komuna e Artanës. Bëhet fjalë për të njëjtin projekt që është pranuar dhe trajtuar me herët nga AAC, të cilin e ka dorëzuar operatori “SOWI Novobërdë L.L.C” me 15.07.2022, respektivisht me 10.02.2021, për të cilin, brenda fushëveprimit të tyre, LKIA ka konstatuar se vendosja e shtyllës dhe ndërtimi i parkut energjetik në lokacionin e propozuar nuk do të paraqesë pengesë për operimet në ANP “Adem Jashari”, kurse ASHNA ka konstatuar se projekti do të paraqet pengesë nëse ndërtohet në atë lokacion.

Mirëpo, bazuar në vlerësimin e fundit të pranuar nga ASHNA, është konstatuar se ndërtimi i shtyllës me matësit e erës në koordinata të paraqitura nuk paraqet pengesë në trajektoret e fluturimit, "holding" mbi PR408, as në MVA (sektori që shtrihet në atë pjesë), prandaj AAC ka njoftuar operatorin se kërkesa është në përputhje me dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 09/2018 për zonat mbrojtëse të aerodromit dhe ka konstatuar që nuk ka kundërshtime, me kusht që plotësohen kërkesat të paraqitura në shkresë.

- ***Ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të ANP “Adem Jashari”***

Në kuadër të përgjegjësiave për rregullimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve, inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullores mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores për shënjimin e pengesave, brenda zonave mbrojtëse të ANP “Adem Jashari”.

Gjatë këtij viti, Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës ka pranuar nga operatori LKIA vlerësimet e dy aplikacioneve për ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”. Në bazë të dokumentacionit të pranuar, vlerësimeve nga LKIA dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), AAC, në përputhje me dispozitat e Rregullores (AAC) Nr. 09/2018 për zonat mbrojtëse të aerodromit, ka vlerësuar se projektet e planifikuara të ndërtohen në afërsi të ANP “Adem Jashari”, nuk paraqesin pengesë për sigurinë e operimeve, me kusht që të respektohen të gjitha kërkesat e paraqitura në vlerësimin e lëndëve.

Në dhjetor të viti 2023 është mbajtur takimi me përfaqësuesin e kompanisë “Vitet Solar Sh.p.k” lidhur me zhvillimin e projektit të parkut fotovoltai në fshatin Sllatinë të Vitisë. Pala është njoftuar se lokacioni për ndërtimin e parkut fotovoltai shtrihet jashtë zonave mbrojtëse të përshkuara në Rregullore (AAC) 09/2018 Mbi Zonat Mbrojtëse të Aerodromit, prandaj nuk ka nevojë për ndonjë vlerësim aeronautik me kusht se, në kuadër të projektit, nuk do të këtë ndonjë objekt të lartë 150 m mbi nivelin e tokës.

### 2.6.3 Auditimet/inspektimet në fushën e sigurisë së fluturimeve (operimet ajrore, vlefshmëria ajrore dhe licencimi i personelit)

#### ***a) Auditimi/inspektimi i Organizatave të Aprovuara Trajnuese (ATO)***

Më 01.11.2023, është lëshuar aprovimi për tre muaj për Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” - LKIA, në cilësinë e ofruesit të trajnimeve për mallrat e rrezikshme, për programin e trajnimit për mallrat e rrezikshme për funksionet e punës 7.2, 7.4, 7.5, 7.6 dhe 7.10, të cilat i mbulojnë të gjitha kategoritë e personelit të LKIA-s.

Më 05.12.2023, është monitoruar mbajtja e kursit trajnues për mallrat e rrezikshme të LKIA-s për funksionin e punës: Personeli përgjegjës për kontrollet e sigurimit të udhëtarëve dhe ekuipazhit dhe bagazheve të tyre, ngarkesave dhe postës (7.10), për nënfunksionin e sigurimit.

#### ***b) Auditimi/inspektimi i organizatave të certifikuara për trajtimin e mallrave të rrezikshme (DGR)***

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur të planifikuar auditim/inspektim të organizatave të certifikuara për trajtimin e mallrave të rrezikshme.

#### ***c) Auditimet/inspektimet në fushën e Aviacionit të Përgjithshëm (GAT)***

Me datë 18.05.2023 inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës kanë kryer inspektime SAFA në fushën e Aviacionit të Përgjithshëm (General Aviation) të mjeteve ajrore (aeroplanëve) të regjistruar në Republikën Veriore të Maqedonisë.

Më datën 23.05.2023 inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës kanë kryer auditimin për operime me paraglidë në regjionin e Kamenicës, në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 06/2020. Qëllimi i këtij audimi ishte inspektimi dhe verifikimi i kushteve dhe metodave të përdorimit të paraglidëve dhe deltaplaneve.

#### ***d) Auditimet/inspektimet në fushën e Mjekësisë së Aviacionit (MED)***

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur të planifikuar auditime/inspektime në fushën e Mjekësisë së Aviacionit.

*e) Inspektimet në platformë (SAFA) të mjeteve ajrore të operatorëve të huaj.*

Programi i Inspektimit të mjeteve të huaja ajrore në platformë (SAFA) është një Program Evropian në lidhje me performancën e inspektimeve në platformë të mjeteve ajrore të përdorur nga operatorët e vendeve të treta ose të përdorura nga operatorët nën mbikëqyrjen rregullatore të një shteti tjetër anëtar të BE-së (SACA). Programi rregullohet në përputhje me Rregulloren (AAC) Nr. 04/2015 mbi kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, të ndryshuar. Për më tepër bazuar në Nenin 50 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve mund të bëjnë inspektimin në platformë dhe/ose kontrollimin në vend, të mjeteve ajrore nga vendet të cilat janë anëtarë të BE-së ose HPEA, si dhe të vendeve të tjera, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2023 kanë kryer njëzete (20) inspektime të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj (SAFA - Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore), të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Në vijim janë të listuar kompanitë ajrore të inspektuara të cilat operojnë në ANP “Adem Jashari”.

**Swiss International Airlines**

IATA: LX  
ICAO: SËR

**Austrian Airlines**

IATA: OS  
ICAO: AUA

**Air Pink**

IATA: YU  
ICAO: PNK

**Trade Air**

IATA: TD  
ICAO: TDR

**Bul Air**

IATA: LZ  
ICAO: LZE

**Easy Jet Europe**

IATA: EC  
ICAO: EJU

**Norwegian Air Shuttle**

IATA: DY  
ICAO: NOZ

**Swiss International Airlines**

IATA: SËR  
ICAO: LX

**Turkish Airlines/AnadoluJet**

IATA: TK  
ICAO: THY

**EasyJet Switzerland SA**

IATA: DS  
ICAO: EZS

**Eurowings**

IATA: EË  
ICAO: EËG

**Aer Club Skopje**

IATA: LË  
ICAO: N/A

**Edelweiss**

IATA: ËK  
ICAO: EDË

**Wizz Air Malta**

IATA: Ë4  
ICAO: ËZZ

**Pegasus Airlines**

IATA: PC  
ICAO: PGT

**Turkish Airlines**

IATA: TK  
ICAO: THY

**Corendon Airlines**

IATA: XC  
ICAO: CAI

Gjatë këtyre inspektimeve vlen të përmendet fakti që Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve nuk kanë konstatuar ndonjë gjetje të kategorisë 3 (veprime korigjuuese para fluturimit), apo ndonjë gjetje e kategorisë 2. Megjithatë janë dy gjetje të Kategorisë 1 (informatë operatorit si dhe shtetit të operatorit).

#### **2.6.4 Auditimet e brendshme të Sistemit të Menaxhimit të AAC-së (Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë dhe Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë, përfshirë Programin Shtetëror të Sigurisë (PShS))**

Përmes PShS-së, kërkohet hartimi dhe zbatimi i një programi të përbashkët, i cili definon qartë strukturën dhe hierarkinë shtetërore të përgjegjësive në sigurinë e aviacionit civil, definon rolet e hisedarëve dhe koordinimin e punëve në mes tyre. Ky program i definon gjithashtu politikatat e shtetit për sigurinë dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Komiteti për Programin Shtetëror të Sigurisë (PSHS) së aviacionit civil në Republikën e Kosovës nuk ka mbajtur takime gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur të planifikuar auditime të brendshme të Sistemit për Menaxhimin e Cilësisë dhe Sistemit për Menaxhimin e Sigurisë.

## **2.7 Mbikëqyrja ekonomike e operatorëve të aviacionit (ASHNA-s, ANP “Adem Jashari” LKIA dhe shërbyesve në tokë)**

### **2.7.1 Certifikimi/licencimi/aprovimi i operatorëve të aviacionit**

- **LKIA:** Më 30 mars 2023, DP ka nxjerrë Vendimin nr. 03/ZDP/2023 përmes të cilit i ka vazhduar aprovimin operatorit të ANP “Adem Jashari” deri më 31 mars 2024. Më 04 prill 2023 në AAC janë pranuar Raportet e audituara financiare të LKIA për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022. Ndërsa më 23 qershor 2023 në AAC janë pranuar raportet e audituara financiare për shërbimet në tokë për vitin 2022. Më 13 korrik 2023 është përfunduar raporti mbi mbikëqyrjen ekonomike të vitit 2022. Në konkluzion të raportit thuhet që LKIA ka kaluar një vit shumë të mirë financiar për shkak të rritjes së trafikut. Gjatë vitit 2022 kompania ka zvogëluar shtrirjen financiare nga borxhi dhe ka rritur nivelin e të ardhurave në raport me mundësinë e pagesës së interesit. Gjatë muajit maj në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të LKIA-së për operimet në ANP. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 4 prill 2023 - 3 prill 2024 dhe ka mbulesë prej 100,000,000 EUR për cilëndo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet. Në konkludim, operatori i aeroportit LKIA po i mirëmban kriteret ekonomike në bazë të të cilave është aprovuar si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në ANP “Adem Jashari”, për kategorinë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10, të shtojcës 1 të Rregullores 4/2011 me ndryshime.
- **Exfis sh.p.k.:** Më 31 janar 2023, AAC i ka vazhduar aprovimin subjektit afarist “Ex Fis” sh.p.k. për një vit si furnizues për palë të treta për shërbimet në tokë për kategorinë 7.1 të shtojcës së Rregullores 04/2011, me ndryshime. Departamenti përgjegjës për rregullim ekonomik të aviacionit gjatë vitit ka bërë mbikëqyrjen e vazhdueshme. Pasqyrat financiare të “Ex Fis” sh.p.k. për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë pranuar në AAC më 26 prill dhe 25 maj 2023. Raporti vjetor i mbikëqyrjes ekonomike është përgatitur më 07 qershor 2023. Analiza ka vërtetuar se kompania e aprovuar nga AAC-ja për furnizim të mjeteve ajrore me karburant është biznes rentabil, si dhe është përmbushur kërkesa nga Rregullorja nr. 4/2011 e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren

5/2019 e AAC-së për ndarje të llogarive të biznesit që zhvillohet në aeroport nga aktivitetet tjera biznesore që zhvillon kjo kompani. Në pasqyrat financiare të audituara në faqe 2 te deklarata e përputhshmërisë është cekur që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me rregullimin dhe kërkesën e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në bazë të Rregullores nr. 4/2011 të AAC të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 5/2019. Në maj në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të Ex Fis për operimet në ANP. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 26 maj 2023 - 25 maj 2024 dhe ka mbulesë prej 500,000,000 USD për cilëndo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet. Në konkludim, “Ex Fis” sh.p.k. po i mirëmban kriteret ekonomike sipas të cilave është aprovuar për të dhënë shërbime në tokë (furnizim me karburant) në ANP “Adem Jashari”.

- **Shprehja e interesit e AAS për të ofruar shërbime në tokë në ANP:** Më 10 maj 2023 kompania Airline Assistance Switzerland (AAS) përmes një emaili dhe shkresave drejtuar Drejtorit të LKIA ka shprehur interesimin për të ofruar shërbime në tokë në ANP “Adem Jashari”. AAC ka udhëzuar AAS mbi kërkesat ligjore dhe procedurat në Republikën e Kosovës për tu aprovuar si ofrues i shërbimeve në tokë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sidoqoftë deri në fund të vitit, kjo kompani nuk e ka dorëzuar aplikimin.

### **2.7.2 Miratimi i tarifave të rregulluara aeronautike**

**Inspektimi në lidhje me projektet kapitale të ASHNA-së të financuara nga tarifa terminale e navigacionit:** Për secilin projekt kapital të cilin AAC e aprovon që ASHNA ta financojë përmes tarifës terminale të navigacionit, përgjatë vitit bën inspektim të shoh realizmin e atyre projekteve. Për vitin 2022 dhe 2023, AAC-ja kishte aprovuar projektet kapitale “Pjesë rezervë për sisteme radarike” përmes Vendimit 11/ZDP/VE/2021 dhe “Sistemi i ri i procesimit të të dhënave ATM” përmes Vendimit 11/ZDP/2022. Gjatë inspektimit të ndërmarrë në dhjetor janë bërë disa gjetje dhe janë dhënë disa konkludime. Raporti i është dërguar ASHNA-s për koment dhe pasi që AAC nuk ka pranuar prapa komente lidhur me këtë inspektim, raportin e inspektimit të nënshkruar e ka dërguar në ASHNA më 19 dhjetor 2023.


**Përcaktimi i tarifës njësi terminale për vitin 2024:** Gjatë raportimit të dytë të plotësuar dhe ndryshuar ASHNA ka dorëzuar propozimet me dt. 03, 11, 22 tetor, 21, 22, 29 nëntor dhe 01 dhjetor 2023. Në departament janë shqyrtuar në mënyrë të detajuar të gjitha dokumentet të vlefshme për të përcaktuar kostot për ofrimin e shërbimit për kompanitë ajrore gjatë vitit 2024. Më 01 dhjetor 2023, ASHNA ka raportuar për mbylljen e afatit tre javor të konsultimit publik (09 nëntor – 30 nëntor 2023) me kompanitë ajrore, ku është thënë që nuk është pranuar asnjë koment. Më 7 dhjetor 2023, DBNRREA ka dorëzuar Rekomandimin të Drejtorit të Përgjithshëm me të gjitha të dhënat mbështetëse për të përcaktuar tarifën njësi terminale për vitin 2024. Më 13 dhjetor 2023, sipas kërkesës së UD DP, është organizuar takim me përfaqësues të ASHNA-s për t’ju sqaruar kalkulimin dhe metodologjinë e përcaktimit të tarifës njësi terminale për vitin 2024. Në takim ASHNA ka mbrojtur propozimin e tyre të parashikimit të trafikut prej 7% për vitin 2024, mirëpo nuk ka dhënë argumente apo dëshmi mbi parashikimin e këtij numri. Ndërsa, AAC ka dhënë argumentet mbi bazë të së cilës është bërë parashikimi i trafikut prej 17% (parashikimi nga LKIA në bazë të orarit të fluturimeve për sezonin dimëror 2023/24 dhe aplikimeve për sezonin veror 2024 si dhe faktit që viti 2024 është viti i parë gjatë të cilit kosovarët mund të udhëtojnë pa viza në zonën Schengen). Më 20 dhjetor 2023, UD Drejtori i përgjithshëm ka lëshuar Vendimin Ekzekutiv nr. 11/ZDP/VE/2023 përmes të cilit ka përcaktuar tarifën njësi terminale në vlerë prej 360 EUR nën parashikimin e rritjes së trafikut prej 14% duke filluar nga 1 janari 2024. BNRREA ka inicuar publikimin e vlerës së tarifës në AIP.

### **2.8 Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion (trajtimi/ hetimi i ndodhive, futja e tyre në formatin/bazën e të dhënave në ECCAIRS)**

Me qëllim të ngritjes së sigurisë së aviacionit, duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja mbledh dhe analizon informacione të nevojshme të sigurisë së aviacionit civil përmes sistemit të saj të raportimit të ndodhive. Këto informacione i mundësojnë AAC-së dhe industrisë që të mbledhin informata për rreziqet e mundshme të sigurisë, me qëllim të mbështetjes së spektrit të plotë të aktivitetëve në menaxhimin e sigurisë, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e veprimeve lehtësuese aty ku është e përshtatshme. Informacionet relevante të sigurisë raportohen, mblidhen, ruhen, mbrohen, shkëmbehen, shpërndahen dhe analizohen në përputhje me kërkesat e Rregullores së AAC-së nr. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil, me ndryshime.

Gjatë vitit 2023, në baza periodike, ndodhitë e pranuar në AAC janë përmbledhur dhe dërguar në KHAIA të pasqyruara në formë tabelore. Gjatë vitit 2023, AAC-ja ka pranuar raportime për gjithsejtë 340 ndodhi në aviacionin civil, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me numrin e ndodhive të raportuara gjatë viteve të fundit. Kjo natyrisht përkon edhe me rritjen e numrit të operimeve në 2023 krahasuar me vitin 2022 që ka shënuar ngritje për 7%.

Numri i përgjithshëm i ndodhive të raportuara në AAC, që nga viti 2006 deri në fund të vitit 2023 ka arritur në gjithsejtë 2447 ndodhi. Besohet se nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në numrin e raportimeve të ndodhive krahasuar me numrin e fluturimeve dhe kjo tregon nivelin e vetëdijesimit të pjesëmarrësve në industrinë e aviacionit dhe përkushtimin e tyre për të raportuar, si dhe mund të tregojë nivelin e kënaqshëm të sigurisë në aviacionin civil. Ndodhitë e raportuara janë koduar në kategori të ndryshme sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi dhe bashkë me kategoritë e ndodhive të tri viteve të mëparshme janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm, i cili është bazuar në të dhënat e nxjerra nga baza e të dhënave e AAC-së në platformën softuerike ECCAIRS 5 (Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve).




Nga grafiku i mësipërm mund të vërehet se në krahasim me kategoritë e ndodhive të viteve 2020, 2021 dhe 2022, kategoritë e vitit 2023 të cilat kanë pasur rritje, disa prej të cilave më të ndjeshme, dhe kanë ndikuar në rritjen e numrit të përgjithshëm të ndodhive janë:

- ATM (menaxhimi i trafikut ajror/komunikimi, navigimi dhe vrojtimi);
- BIRD (goditja e shpendëve);
- SEC (e lidhur me sigurimin, e cila përmban nënkategorinë e ndodhive të lidhur me sulmet me laser);
- WILD (përplasje me kafshët e egra); dhe
- RI (futja në pistë - e automjetit, mjetit ajror ose e personit);

- ADRM (aerodromi)

Ndërsa, kategoritë e ndodhive që kanë pësuar rënie të konsiderueshme në vitin 2023 janë:

- RAMP (Trajtimi në tokë) dhe
- NAV (gabimi në navigacion).



Siç mund të shihet në grafikun e mësipërm, nga 340 ndodhitë e pranuar në AAC gjatë vitit 2023, muajt me numrin më të madh të ndodhive janë muajt e verës (korrik, gusht dhe shtator) kur edhe numri i fluturimeve është më i madh. Po ashtu, gjatë këtyre muajve ka ndodhur edhe numri më i madh i goditjeve të shpendëve. Ndodhitë e raportuara po ashtu janë klasifikuar në klasa të ndryshme bazuar në ashpërsinë e ndikimit të tyre në operimet e sigurta të mjeteve ajrore dhe në njerëzit në bordin e tyre, por jo të gjitha ndodhitë e vitit 2023 janë klasifikuar ende.

### 3. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR DHE NDËRINSTITUCIONAL DHE NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE

#### 3.1 Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

##### 3.1.1 Anëtarësimi në ICAO

Më 5 shkurt 2023, përfaqësues nga AAC kanë marrë pjesë në takimin e ftuar nga MPJD/Departamenti për organizata ndërkombëtare. AAC është njoftuar se MPJD ka përfshirë ICAO-n në listën e 4 organizatave me prioritet të lartë për anëtarësim dhe ka kërkuar që bartës të procesit sa i përket hartimit të dokumenteve profesionale teknike të jetë AAC ndërsa MPJD do të shtojë në dokument veprimet që kërkojnë angazhim politik kryesisht të ndërlidhur me lobimin. MPJD kërkoi përkrahje profesionale nga AAC lidhur me aplikimin dhe anëtarësimin në ICAO. Më 3 mars 2023, AAC ka përcjellë në MPJD dokumentin gjithëpërfshirës “Procedura e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në ICAO” lidhur me aplikimin, sfidat, dobitë, skenarët e mundshëm të anëtarësimit të RKS në ICAO. Sidoqoftë, gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndonjë zhvillim në drejtim të anëtarësimit në ICAO.

##### 3.1.2 Anëtarësimi në ECAC dhe Eurocontrol

Anëtarësimi në ICAO është parakusht që një shtet të konsiderohet për anëtarësim në organizatat panevropiane të aviacionit - Konferencën Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC) dhe Organizatën

Evropiane për Sigurinë e Navigimit Ajror (EUROCONTROL). Për këtë arsye, gjatë vitit 2023 nuk ka zhvillime sa i përket anëtarësimit në këto dy organizata. ECAC-u nxjerr politika ndërqeveritare në nivel evropian, ndërsa EUROCONTROL-i ndihmon në menaxhimin e hapësirës ajrore evropiane përmes krijimit të rregullave dhe ofrimit të shërbimeve

### **3.2 Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale**

#### **a) Bashkëpunime ndërkombëtare**

Në kuadër të MoU-së që AAC ka me ICETRA, kjo e fundit ka realizuar një vizitë në AACK nga data 8 deri me 12 maj 2023. Po ashtu, gjatë vitit 2023 ka qenë e planifikuar vizita dytë nga ICETRA nga data 2 deri me 6 tetor 2023, por është shtyrë me datë 20 deri me 24 nëntor 2023. Në ndërkohë gjatë kësaj periudhe është realizuar një desktop audit, ku AAC është përgjigjur në pyetësorët e dërguara nga ICETRA. Ky audit është realizuar në dy faza duke filluar nga data 06.10.2023 deri me datë 11.10.2023, dhe nga data 12.10.2023 deri me datë 18.10.2023. Draft raporti i këtij auditi është diskutuar gjatë auditit 20 deri me 24 nëntor 2023. Si rrjedhojë presim raportin final të auditimit të dërgohet gjatë muajit janar 2024.

#### **b) Bashkëpunimet rajonale**

Gjatë periudhës së raportimit AAC ka vazhduar edhe më tutje bashkëpunimin me autoritetet e aviacionit civil në rajon.

Gjatë vitit 2023, në kuadër të marrëveshjes dypalëshe, inspektorët e aerodromeve kanë pranuar ftesë zyrtare nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë, për tu bërë pjesë auditimit gjithëpërfshirës të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”, në kuadër të procesit të mbikëqyrjes të certifikatës kundrejt rregullores e EASA 139/2014. Pas përfundimit të rishikimit të dokumentacionit të prezantuar nga aeroporti, nga data 9 deri me 10 nëntor 2023 është realizuar auditimi me qëllim verifikimin e zbatimit dhe përbushjes së kërkesave rregullatore lidhur me trajnimin e personelit, programet e trajnimit dhe zbatimi i tyre, si dhe mbi përbushjen e kërkesave mbi Menaxhimin e platformës në ANT “Nënë Tereza”.

Më datë 09 mars 2023, me ftesë të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë (AACSH), në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të AACK dhe AACSh është realizuar një vizitë pune e mjekut AMA në Tiranë. Gjatë vizitës, u shqyrtuan dhe u administruan raportet e ekzaminimeve mjekësore që u dorëzuan në Sektorin e Licencimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit Ajror në shkurt 2023 nga ana e Qendrës Aero-Mjekësore (AeMC) – Spitalit “Salus” në Tiranë. Po ashtu më datë 10 maj 2023 me ftesë të AACSh, janë administruar dosjet aero-mjekësore të kontrollorëve të trafikut ajror të ALBCONTROL për periudhën mars-prill 2023, si dhe është zhvilluar një vizitë pune në Spitalin “SALUS”, institucion ky i autorizuar në cilësinë e Qendrës së Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Republikën e Shqipërisë. Më tutje më datë 03 gusht dhe 04 tetor 2023 me ftesë të AACSh, Vlerësuesi i Autorizuar Mjekësor (AMA) ka qëndruar në Tiranë në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit (MoM) në mes të dy autoriteteve tona në përgjigje të kërkesës për asistencë teknike në fushën e mjekësisë së aviacionit në kuadër të Drejtorisë të Trajnimit dhe të Licencimit të Tiranë të AACSh. Kërkesa për asistencë është përqendruar në:

- a) Vlerësimin e raporteve mjekësore të dërguara nga AeMC “Salus” në AACSH, gjatë periudhës korrik-shtator 2023.
- b) Asistencë në lidhje me revizionimin e Manualit të PEL, për pjesën MED
- c) Asistencë në lidhje me hartimin e manualit udhëzues " Promovimi i Shëndetit në Aviacion (Health Promotion in Aviation)"

Në anën tjetër, sipas marrëveshjes dypalëshe me Autoritetin e Aviacionit Civil të Maqedonisë së Veriut, inspektorët e aerodromeve kanë marrë pjesë në inspektimin e rregullt në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit. Pas rishikimit të dokumentacionit relevant për inspektim, me 12.12.2023 është realizuar



inspektimi me qëllim të verifikimit të kapaciteteve të shërbimit dimëror dhe operimeve për shkrije dhe kundër-ngrije të aeroplanit.

Ky bashkëpunim u vlerësuan shumë pozitiv nga të gjitha palët sepse mundësuan shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizave të inspektorëve që më tutje do të aplikohen në interes të ngritjes së standardeve të aviacionit, dhe për më shumë krijuan lidhje edhe më të ngushtë në mes institucioneve.

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil të Republikës së Maqedonisë Veriore me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ekspertizës, inspektorët SAFA të Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve në bashkëpunim me inspektorët SAFA të CAA-RNM-së kanë realizuar 3 inspektime të përbashkëta të aeroplanëve të operatorëve të huaj të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit (LWSK).

### **3.3 Aranzhimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritet shtetërore për mbrojtjen e mjedisit**

- *Memorandumi i mirëkuptimit mes AAC-së dhe Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*

Gjatë vitit 2023, AAC ka vazhduar të komunikoj me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç’rast janë mbajtur disa takime mes përfaqësuesve të AAC-së, Sekretarit të përgjithshëm të MMPHI, inspektorëve të mbrojtjes së natyrës në kuadër të MMPHI dhe përfaqësuesve të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (ANMK), ku është diskutuar për menaxhimin e rrezikut nga bota shtazore në ANP “Adem Jashari”.

Në këto takime është konkluduar se është e domosdoshme që të bëhet një studim i habitatit në Ligatinën e Hencit dhe rrethinë, në mënyrë që të kuptohet saktësisht se çfarë lloj i botës shtazore jeton në ato zona dhe cilat janë lëvizjet e tyre gjatë vitit. Ky studim është i domosdoshëm si për mbrojtjen e ligatinës si zonë e mbrojtur ashtu edhe për menaxhimin e rrezikut nga bota shtazore në ANP “Adem Jashari” dhe rrethinën e tij. Për kryerjen e këtij studimi, përfaqësuesit e AMMK-së dhe MMPHI-së u deklaruan që nuk kanë kapacitete të brendshme, pasi kërkohen ornitologë (ekspertë për shpezë) dhe puna disa vjeçare në terren për të realizuar studimin siç duhet. Gjithashtu, do të shikohen edhe mundësitë tjera, alternative, në institucione tjera të vendit dhe jashtë vendit.

Në anën tjetër, është ngritur shqetësimi që Ligatina e Hencit, që përmes Vendimit të Qeverisë nr. 08/178 të dt. 18.03.2014 është shpallur zonë e mbrojtur e zogjve, vazhdon të jetë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore dhe menaxhohet nga AKP. Përfaqësuesi i AMMK konfirmoj që rekomandimi për të kërkuar menaxhimin e kësaj zone nga Ministria është bërë paraprakisht, por ende nuk ka ndodhur. Mbetet interes i përgjithshëm që kjo zonë të mos të lejohet të privatizohet.

AAC është shprehur se përmes një memorandumi të bashkëpunimit do të kërkojë mbështetje nga MMPHI në fushën e menaxhimit të botës shtazore në ANP dhe në rrethinën tij.

Gjatë këtij viti, më saktësisht me datë 12.07.2023, është mbajtur një takim me Ministrin Aliu , po ashtu është mbajtur edhe një takim në MMPHI me datën 14.07.2023 me sekretarin e përgjithshëm dhe bashkëpunëtorët e tij ku është dakorduar se është e domosdoshme që të bëhet një studim i habitatit dhe lëvizjes së shpezëve në aeroportin e Prishtinës dhe rrethinën e tij (Ligatina e Hencit, kodra e Goleshit etj.), në mënyrë që të kuptohet saktësisht se çfarë lloj i botës shtazore jeton në ato zona dhe cilat janë lëvizjet e tyre gjatë vitit. Ky studim është i domosdoshëm si për mbrojtjen e ligatinës si zonë e mbrojtur ashtu edhe për menaxhimin e rrezikut nga bota shtazore në ANP “Adem Jashari” dhe rrethinën e tij.

Për të parë mundësitë e mëtutjeshme për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e menaxhimit të botës shtazore në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe në rrethinën tij (Ligatina e Hencit, kodra e Goleshit etj.), është rekomanduar që të draftohet një dokument bashkëpunimi (Marrëveshje Mirëkuptimi) për të përcaktuar veprimet e mëtutjeshme lidhur me këtë proces.

Drafti i parë i Marrëveshjes së Mirëkuptimit është përgatitur nga AAC dhe është dorëzuar me 21.07.2023. AAC është ende në pritje të komenteve nga MMPHI.

### 3.4 Implementimi i Projektit të Bashkëpunimit Teknik të EASA-s, EASA IPA-6

Projekti EASA IPA 6 nuk është miratuar ende nga Komisioni Evropian gjatë vitit 2023 prandaj EASA nuk ka mundur të zhvillojë asnjë aktivitet.

### 3.5 Normalizimi i hapësirës ajrore

Hapësira e lartë ajrore e Republikës së Kosovës e cila përdoret për mbikalime të aeroplanëve civil është e deleguar përkohësisht nga NATO, në pajtim me institucionet e Kosovës, te HungaroControl, gjegjësisht Hungaria. Ndërsa hapësira e ulët ajrore kontrollohet nga ASHNA, dhe në këtë hapësirë përdoren vetëm dy korridore për trafik komercial, për hyrje dhe dalje nga territori i Kosovës, të cilat ndodhen në kufi me Maqedoninë e Veriut. Për një operim plotësisht funksional në territorin e Republikës së Kosovës, përveç normalizimit të plotë të hapësirës së ulët ajrore për aviacionin e përgjithshëm, shfrytëzimi i plotë i hapësirës është element thelbësor, prandaj AAC-ja do ta përkrahë ASHNA-n në përgatitjen për:

*3.5.1 Menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore*

*3.5.2 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë*

*3.5.2 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Mali i Zi.*

#### **3.5.1 Menaxhimin e hapësirës së lartë ajrore**

Hapësira ajrore e Kosovës që nga shtatori i vitit 1999 është pjesë e “Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit – JOA” të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të Operimeve të Kombinuara Ajrore 5 (Combined Air Operations Control 5 - CAOC5), e cila në vitin 2014 është transferuar te Qendra Torrejon e Operimeve të Kombinuara Ajrore (Combined Air Operation Centre Torrejon CAOC TJ). Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime të trafikut ajror.

Në bazë të marrëveshjes në mes të NATO/KFOR-it dhe Hungarisë, hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi 6205 m) që nga prilli i vitit 2014 menaxhohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl, i cili u ofron shërbime aeroplanëve që e mbikalojnë këtë hapësirë. Vazhdimi i ofrimit të këtyre shërbimeve nga HungaroControl është bërë në vitin 2019, pas përfundimit të periudhës pesëvjeçare nga viti 2014.

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës (nën 6205 m) menaxhohet/kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), e cila ofron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Gjithashtu, shërbime ofrohen edhe për fluturimet e KFOR-it, EULEX-it dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit. Hapësira e ulët ajrore është e klasifikuar si hapësirë e klasës D dhe G, në përputhje me dispozitat mbi klasifikimin e hapësirës ajrore nga Aneksi 11 i ICAO-s.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur strukturat aktuale të hapësirës ajrore të Kosovës (hapësira e ulët dhe e lartë).

- ***Hapësira e ulët ajrore e Kosovës***

Në hapësirën e ulët ajrore aktualisht janë vetëm 2 korridore (shih figurën 1) që përdoren për trafik komercial për vajtje-ardhje nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Këto janë XAXAN dhe SARAX në pjesën jugore të Kosovës në drejtim të Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të diskutimeve për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, më 18 qershor 2020 ASHNA ka nënshkruar Letër Marrëveshje midis ASHNAs dhe ofruesit shqiptar të shërbimeve AlbControl Tirana ACC, përmes të cilës janë hapur edhe dy pika tjera, KUKAD dhe ARBER, në kufi me Republikën e Shqipërisë, që mund të shfrytëzohen për koordinim të fluturimeve, siç është paraqitur në figurën 2.

Këto pika janë shfrytëzuar në baza taktike dhe përdorur për koordinim të trafikut komercial ndërmjet ASHNAs dhe AlbControl, mirëpo sipas raporteve në media janë bërë të planifikueshme për fluturim (flight plannable).




Figura 1. Struktura e hapësirës së ulët ajrore në Republikën e Kosovës




Figura 2. Pikat e reja, KUKAD dhe ARBER për koordinimin e fluturimeve me Tirana ACC

- **Hapësira e lartë ajrore e Kosovës**

Struktura e hapësirës së lartë ajrore përbëhet nga 2 sektorë (shih figurat 3 dhe 4) nga niveli i fluturimit FL205 (6 km) deri në FL285 (9 km) dhe nga niveli i fluturimit FL285 (9 km) deri në nivelin e fluturimit FL660 (20 km)

Sektori 1 (FL205 deri në FL285) përbëhet nga 4 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR.

Sektori 2 (FL285 deri në FL660) përbëhet nga 5 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR;

5. Korridori UL603, i cili fillon nga pika hyrëse VABEK dhe përfundon në pikën dalëse LONTA.




Figura 3. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 1 (FL205 deri në FL285)




Figura 4. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 2 (FL285 deri në FL660)

• **Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës**

Pas përfundimit të luftës, hapësira e lartë ajrore e Kosovës ka qenë e mbyllur për mbikalime të avionëve civil, dhe nën autoritetin e NATO-s. Kjo hapësirë u hap për fluturime komerciale në vitin 2014, nën menaxhimin e HungaroControl-it. Kontrollorët tanë të trafikut ajror ofrojnë shërbime në hapësirën e ulët ajrore dhe menaxhojnë ngritjet dhe aterrimet në/nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe për fluturimet tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës (të shumtën helikopterë të KFOR-it).

Kontrolli i trafikut ajror në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës është nën mbikëqyrjen rregullatore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë, autoritetet e Republikës së Kosovës kanë punuar ngushtë me NATO-n, KFOR-in, BE-në, ICAO-n dhe hisedarët tjerë në rajon për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit. Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të nismës së NATO-s: Mbledhja për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (*ang. Balkans Airspace Normalization Meeting – BANM*). Interesim të madh kanë pasur edhe kompanitë ajrore, sepse mbi Kosovë kalojnë disa rrugë që historikisht janë shfrytëzuar shumë në trafikun ajror ndërkombëtar. Meqë tanimë hapësira e lartë ajrore me rihapjen për fluturime komerciale në vitin 2014 konsiderohet e normalizuar, aktivitetet në kuadër të BANM-it janë të fokusuar në normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, që nënkupton para së gjithash hapjen e korridoreve të reja ajrore me të gjitha shtetet fqinje.

Në vitin 2017, për herë të parë, nën udhëheqjen e NATO-s filluan që mbledhjet e BANM-it të organizohen në të ashtuquajturin “nivel ekspertësh”. Pjesëmarrës në këto takime ishin nga Republika e Kosovës, Republika e Serbisë, e Malit të Zi si dhe përfaqësues të KFOR-it.

Gjatë vitit 2023, sikurse edhe në vitin paraprak, nuk kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me shtetet fqinje të Kosovës, në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM).

### 3.5.2 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Shqipëri

Formalizimi dhe publikimi i pikave KUKAD dhe ARBER ishte planifikuar në fund të nëntorit 2023, për arsye të ndryshme procedurale dhe koordinuese nga ana e autoriteteve të Shqipërisë është shtyrë, dhe me koordinim dhe përkrahjen e vazhdueshme të shteteve përkrahëse për këtë proces si dhe përfaqësues të ICETRA dhe NATO, funksionalizimi formal është realizuar nga data 28 dhjetor 2023 prej kur të gjithë operatorët ajror kanë mundur të bëjnë planifikimin e fluturimeve dhe rrugëve ajrore përmes këtyre pikave.

### 3.5.3 Hapjen e korridorit ajror në hapësirën e ulët ajrore Kosovë - Mali i Zi

Procedurat PBN, që lidhin Kosovën me Malin e Zi, janë të aprovuara nga SHNA, si pjesë e ndryshimit për projektin e zgjatjes së pistës.

Procesi i negociimit për formalizimin e këtyre rrugëve ajrore është duke u zhvilluar në vazhdimësi në koordinim mes ASHNA, AAC, NATO, ICETRA, si dhe shtetet mbështetëse të këtij procesi, për të finalizuar marrëveshjen dhe implementimin me autoritetet e Malit të Zi.

## 4. BUXHETI I AAC-së PËR VITIN 2023

Buxheti sipas kërkesës së Autoritetit të Aviacionit Civil dhe sipas Qarkores Buxhetore 2023/2 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është i paraqitur në vijim:

Kategoria	Qarkorja buxhetore 2023/02 - MFPT	Kërkesa buxhetore 2023 e AAC-së	Diferenca: Kërkesa Buxhetore 2023- Qarkorja Buxhetore 2023/02 - MFPT
Paga dhe Mëditje	768,543.00	1,028,061.00	(259,518.00)
Mallra dhe Shërbime	150,000.00	281,456.00	(131,456.00)
Shpenzime Komunale	3,738.00	3,738.00	-
Shpenzime Kapitale	-	-	-
<b>Totali i Buxhetit</b>	<b>922,281.00</b>	<b>1,313,255.00</b>	<b>(390,974.00)</b>

Në vijim është tabela e buxhetit të shpenzuar të AAC-së për vitin 2023.

Kategoria	Buxheti i shpenzuar për vitin 2023	Objektiva I	Objektiva II	Objektiva III
		35%	50%	15%
Paga	650,395.24	227,638.33	325,197.62	97,559.29
Mallra & Shërbime	88,958.45	31,135.46	44,479.23	13,343.77
Shpenzime Komunale	591.09	206.88	295.55	88.66
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>739,944.78</b>	<b>258,980.67</b>	<b>369,972.39</b>	<b>110,991.72</b>

## **5. REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E PLANIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN VIJUES DHE ADRESIMIN E PROBLEMEVE TË HASURA GJATË ZBATIMIT**

Të gjitha objektivat dhe veprimet të cilat janë paraqitur në Planin e Performancës së AAC-së për vitin 2023, për të cilat nuk ka pasur aktivitete për të raportuar në këtë raport, është për shkak që veprimet nuk kanë qenë të planifikuara nga njësitet përgjegjëse përbrenda AAC-së.

Për këtë arsye si rekomandim për përmirësimin e planit të performancës për vitin vijues, është që në planin e performancës të përfshihen vetëm objektivat dhe veprimet që janë planifikuar nga njësitë përkatëse të AAC-së dhe duhet të jenë të qarta, konkrete, të matshme, të arritshme dhe reale.

Ndërsa të gjitha objektivat dhe veprimet ku AAC nuk ka përgjegjësi direkte në zbatimin e tyre sipas kompetencave të AAC-së që rrjedhin nga Ligji për aviacionin civil, me ndryshime, duhet të rishikohen gjatë përpilimit të planit të performancës. AAC mund të ketë rol përkrahës dhe këshillëdhënës për përmbushjen e objektivave që nuk janë në përgjegjësi direkte të saj, dhe jo të jetë bartëse e procesit.

Si përfundim, anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare të aviacionit civil, do të mundësojë që AAC të jetë pjesë e forumeve të ndryshme profesionale të sigurisë në aviacion, të pranojë informata, risi, kërkesa dhe përvoja ndërkombëtare, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të AAC-së, në raport me kërkesat legjislative ndërkombëtare dhe adresimin e problemeve të hasura gjatë zbatimit të tyre.

Një faktor determinues në përmbushjen e detyrave sipas përgjegjësi ligjore të AAC-së, është edhe stafi profesional, i kualifikuar dhe mirë i trajnuar. Për të përmbushur këtë kërkesë, AAC ka nevojë për buxhet të mjaftueshëm të dedikuar për mirëmbajtjen dhe ngritjen profesionale, në fushën e sigurisë së aviacionit, dhe jo vetëm.

Si përfundim, duhet të merret në konsideratë që shkak të natyrës së punëve në AAC, ka disa veprime dhe aktivitete që nuk mund të planifikohen paraprakisht në mënyrë të saktë. Kjo për arsye që disa veprime (aktivitete) ndërliken me palët e treta dhe me ndodhitë në aviacion, si p.sh. lëshimi i direktivave të sigurisë për raste kur duhet reagim i shpejtë i institucionit për çështje të caktuara të sigurisë, licencave, certifikimeve dhe aprovimeve të ndryshme. Kjo situatë e bën të vështirë për të parashikuar me saktësi të gjitha veprimet që do të ndërmerren gjatë vitit. Në përputhje me këtë, duhet të kemi një qasje më fleksibile dhe të përshtatshme për të menaxhuar situatat e papritura dhe për të siguruar që punët të realizohen me sukses dhe në përputhje me standardet e sigurisë në aviacion.

## SHTOJCA II - Raporti vjetor i Performancës për vitin 2023

<b>Data:</b>	28.03.2024					
<b>AGJENCIA</b>	AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS					
<b>MINISTRIA PËRGJEGJËSE</b>	MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTUËS					
<b>Misioni i Agjencisë</b>	<i>Misioni i AAC-së është ofrimi i shërbimeve si dhe ushtrimi i përgjegjësive përkatëse me qëllim të mundësimit të një sistemi më të mirë të mundshëm të aviacionit civil duke respektuar nivelin e lartë të standardeve të sigurisë. AAC punon në krijimin e një ambienti të aviacionit civil në përputhshmëri me politikat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare, përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme, nivelit të lartë të kompetencës profesionale dhe partneritetit me industrinë.</i>					
<b>Objektivat</b>	<b>Treguesi(t)</b>	<b>Vlera e synuar</b>	<b>Vlera faktike</b>	<b>Rezultatet (Autputet) e planifikuara</b>	<b>Rezultatet (Autputet) e përfunduar a(Po/Jo)</b>	<b>Shënim shpjegues</b>
1. Plotësimi i legjislacionit sekondar	Harmonizimi i akteve normative vendore me ato ndërkombëtare	N/A <sup>1</sup>	1.1. Nëntë (9) rregullore të transpozuara. 1.2. Një (1) rregullore bazuar në specifikat e vendit. 1.3. Dymbëdhjetë (12) Vendime Ekzekutive	Qasja në akte nënligjore përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të RKS	Po	Shih pikën 1 të raportit të bashkangjitur
2. Certifikimi i operatorëve, licencimi i personelit dhe mbikëqyrja e vazhdueshme	Realizimi i aktiviteteve mbikëqyrëse		2.1 Nuk ka pasur kërkesa 2.2 njëzet e dy (22) Ripërtëritje të licencave për KTA; tre (3) Suspendime të licencave për KTA; tridhjetë e dy (32) ekzaminime mjekësore.  2.3 njëmbëdhjetë leje (11) VFR;	Raportet nga auditimet/inspektimet, certifikatat, licencat e lëshuara etj.	Po	Shih pikën 2 të raportit të bashkangjitur

<sup>1</sup> Në planin e performancës të vitit 2023, të dorëzuar nga AAC në nëntor të vitit 2022, nuk kanë qenë të parapara vlerat e synuar për përbushje të planit të performancës. Për këtë arsye në këtë Raport Vjetor do të paraqiten vlerat faktike.

		<p>Njëqind e një leje (101) diplomatike; dyqind e pesë (205) leje për mallra të rrezikshme.</p> <p>2.4 dyqind e njëzet e nëntë (229) aprovime të fluturime.</p> <p>2.5 dyzet e katër (44) regjistrime të SAP/dhjetë (10) shqiptime të gjobave.</p> <p>2.6.1 pesë (5) auditime nga ShNA.</p> <p>2.6.2 njëmbëdhjetë (11) auditime/inspektime nga ADR.</p> <p>2.6.3 një (1) auditim GAT dhe njëzet inspektime (22) SAFA.</p>			
3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstitucional dhe normalizimi i hapësirës ajrore	Anëtarësimet/ lidhja e marrëveshjeve/ implementimi i projekteve/ normalizimi i hapësirës ajrore	Hapja e dy korridoreve me Rep e Shqipërisë	Takim me Ministrinë relevante/ hapja e korridoreve ajrore	Po	Shih pikën 3 të raportit të bashkangjitur

**Z. Burim Dinarama**, U.D Drejtor i Përgjithshëm i AAC